



UNMIK



IPVQ

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT**

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

**Ministria e Energjisë dhe
Minierave**

**Ministry of Energy and
Mining**

**Ministarstvo Energije i
Rudarstva**

Njësia për Integritime Evropiane

**Progresi në kuadër të Planit të Veprimit për
Partneritet Evropian (PVPE-së) për periudhën
shkurt-prill 2007**

7 maj 2007

Në tremujorin e parë që përfshin periudhën shkurt-prill 2007 për progresin e PVPE-së që e udhëheq Grupi Punues për Energji i udhëhequr nga Ministria për Energji dhe Miniera kemi progresin që raportohet në vijim:

I. Progresi

Prioriteti 5: Krijimi i kushteve për investim, tregti, punësim dhe zhvillim ekonomik për përfitim të të gjitha komuniteteve

Në kuadër të Prioritetit 5 për krijimin e kushteve për investime në sektorin e energjisë ka progres në kuadër të plotësimit të bazës ligjore dhe rregullatore. Gjatë këtij tremujori:

- (i) Është nënshkruar nga PSSP Ligji për Enët nën Presion,
- (ii) Është avancuar në përgatitjen e draftit të një vendimi të qeverisë për përgatitjen e procedurave për nxitjen e ndërtimit të hidrocentraleve të vogla duke tërhequr investime vendore dhe të huaja private
- (iii) KOSTT ka përgatitur dhe ZRRë ka miratuar një numër kodesh e rregulloresh:
 - a. Kodi i Rrjetit
 - b. Kodi i matjes
 - c. Procedurat e administrimit të kodeve teknike dhe operacionale
 - d. Procedurat e përcaktimit të kapaciteteve të transmisionit
- (iv) MEM ka përgatitur dhe miratuar udhëzimin administrativ për kushtet që duhet të plotësohen nga konsumatorët e privilegjuar për vitin 2007, dhe
- (v) ZRRë ka miratuar tarifën e reja për energjinë elektrike për klasat e ndryshme të konsumatorëve.
- (vi) Progres vazhdon të ketë në kuadër të projektit të madh 'Energjia nga Ligniti'.
 - a. Është ngritur Zyra e Projektit
 - b. Ka filluar negociatat me Këshilltarët e Transaksionit dhe Këshilltarët Ligjorë

Mirëpo, nuk ka pasur ndonjë lëvizje në miratimin e ligjeve të tjera që ndikojnë në krijimin e kushteve për investime si (i) Miratimi nga Kuvendi i amendamenteve të propozuara në

**Progresi në kuadër të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE-së)
Për periudhën shkurt-prill 2007**

ligjet për sektorin e energjisë, (ii) Ligji për Minierat, dhe (iii) Mineralet dhe Ligji për Hulumtimet Gjeoplogjike. Këto dy ligjet e fundit ende presin nënshkrimin nga PSSP-ja.

Prioriteti 42: Përfundimi i inkorporimit/korporatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, përkatësisht ndërmarrja elektrike, hekurudhat, shërbimet ngrohjes qendrore, furnizimi me ujë dhe mbeturinave. Zbatimi i hapave të mëtejshëm rristrukturuese për përmirësimin e qeverisjes së tyre, efijencës dhe qëndrueshmërisë financiare. Forcimi i mëtejshëm i kuadrit rregullator për shërbimet publike dhe përmirësimi i kapaciteteve administruese të rregullatorëve të pavarur.

Ndërmarrjet energjetike, përfshirë KEK-un dhe Ngrohtoret, vazhdojnë të në gjendje të paqëndrueshme financiare, kryesisht si rezultat i mos inkasimit dhe mos faturimit të plotë të energjisë. Kjo është arsyeja kryesore që situata e furnizimit të Kosovës me energji elektrike është e vështirë.

KEK-u është riorganizuar duke bërë largimin e disa pozicioneve ekzekutive, ka punuar Planin Afarist dhe secili Funkcion Thelbësor (Qymyri, Gjenerimi, Rrjeti dhe Furnizimi), dhe ka përgatitur Planet e Veprimit për të siguruar arritjen e objektivave të Planit Afarist. Për të qenë në gjendje të bëjë llogaritjen e energjisë e cila jepet për shitje, KEK-u ka kompletuar vendosjen e njehsorëve në dhënësit 10kV. Njehsorët KOSTT-KEK janë kontrolluar dhe puthitur, janë instaluar njehsorët për vet konsumimin e KEK-ut dhe janë emëruar personat përgjegjës për secilin dhënës 10kV, përgjegjës për sasinë e energjisë.

KEK-u i ka dorëzuar UNMIK-ut faturën prej 87 milionë € për energjinë e liferuar në enklavat në të cilat KEK-u nuk ka qasje në njehsorët e konsumatorëve.

Pas kërkesës së Qeverisë së Kosovës për mosaplikim të tarifave të reja, KEK-u ka aplikuar në ZRRë për reduktimin e kërkesës së të hyrave të veta për 7 milionë €, e cila do të rezultojë nga eliminimi i rritjes së tarifave.

Mungesa e njehsorëve në nivelin 0.4kV është njëra prej arsyeve kryesore për humbjet komerciale të KEK-ut, pasi KEK-u nuk mund të faturojë atë që nuk mund ta masë dhe të verifikojë rrjedhën e energjisë. KEK-u ka përpunuar planin e njehsimit me instalimin e

**Progresi në kuadër të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE-së)
Për periudhën shkurt-prill 2007**

mbi 5,000 njehsorëve në dhënësit 0.4kV për të siguruar bilancin e sistemit energjetik dhe për të përmirësuar inkasimin. Deri në fund të muajit Maj 2007, e gjithë kategoria e konsumatorëve pasiv (konsumatorët e ndërprerë) do të largohen nga sistemi i konsumatorëve. Leximi i njehsorëve dhe shkyçjeve janë duke u bartur në Divizionin e Rrjetit në mënyrë që të kemi vetëm një organizatë përgjegjëse për liferim të energjisë, matjes dhe shkyçjes. Planet janë që të llogaritet së paku 90% e energjisë, të faturohet 100% e energjisë së njehsuar, dhe të inkasohen 78% e energjisë së faturuar në vitin 2007.

Në kuadër të forcimit të kornizës rregullatore dhe zhvillimin e tregut të energjisë, KOSTT ka përgatitur dhe ZRRrE ka miratuar një numër kodesh dhe aktesh nënligjore të rëndësishme për funksionalizimin e tregut të energjisë elektrike, fillimisht në formën e një tregu tranzitor për vitin 2007. MEM, sipas kërkesës së ligjit për energji e ka mbështetur më parë hapjen graduale të këtij tregu, me lëshimin e udhëzimit përkatës administrativ për kushtet që duhet të plotësohen nga konsumatorët e privilegjuar për vitin 2007.

Në kuadër të reformës tarifore, Zyra e Rregullatorit të Energjisë pas miratimit të hyrave të lejuara për KEK-un dhe KOSTT-in në Dhjetor 2006 me 15 Mars 2007 ka aprovuar edhe tarifën përkatëse të transmisionit dhe shitjes së energjisë elektrike me pakicë në bazë të aplikacionit të kompanive në fjalë dhe pas një procesi të analizimit që ka zgjatur afër një vit. Shqyrtimi i çmimit është bërë me ndihmën e konsultancës kompetente (KEMA) të mbështetur financiarisht nga Banka Botërore. Pas njoftimit të bërë me 17 Mars 2007 reagimi i Qeverisë (Kryeministrit) dhe i publikut ka qenë i tillë që është krijuar një ambient shumë i vështirë për zbatimin e tyre që është dashur të filloj me 1 Prill 2007. Në reagimet të subjekteve politike kanë dominuar aspektet politike më tepër se elementet profesionale të reformës tarifore.

Përfundimisht KEK-u në bazë të presionit të bërë me dt. 25 Prill 2007 ka aplikuar për të hyra më të vogla për 5% se ato paraprakisht të aprovuar në dhjetorin e vitit 2006 e që duhet të reflektojnë nivelin e të hyrave të vitit 2006. Rishqyrtimi si proces që duhet të zhvillohet gjatë muajit maj do të thotë një zvogëlim në mesatare të tarifave paraprakisht të aprovuara dhe në mesatare në nivelin e njëjtë në krahasim me tarifën e vjetra për konsumatorët shtëpiak. Procesi është në vazhdim.

Prioriteti 73: Fillimi i implementimit të zotimeve të ndërmarra në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE). Sigurimi i funksionimit të qëndrueshëm dhe stabil të kompanisë elektrike, posaçërisht duke rritur inkasimin dhe përmirësimin e strukturës qeverisëse korporatave

Mund të themi që Prioriteti 73 është një nga Prioritetet më kryesore për sektorin e energjisë sidomos drejt integritimeve evropiane. Deri më tani Kosova është duke i plotësuar me shumë sukses të gjitha detyrimet që dalin nga Traktati për Komunitetin e Energjisë.

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve në kuadër të Traktatit për Komunitetin e Energjisë, institucionet e Kosovës kanë përgatitur Planin e Veprimit për Implementimin e acquis për Burimet e Ripërtërishme. Zbatimi në praktikë i këtij plani kërkon bashkëpunim më të ngushtë edhe me MMPH dhe MTI.

Po ashtu, nevojiten fonde për të implementuar një numër të projekteve për eficiencën e energjisë dhe burime të ripërtërishme.

KOSTT informon se persa i përket alokimit të kapaciteteve transmetuese të linjave interkonektive të Kosovës edhe më tutje bëhet nga EMS – Elektro Mreza Serbije. Disa aktivitete të rëndësishme të KOSTT në kuadër të Traktatit për Komunitetin e Energjisë janë:

- Pjesëmarrja e KOSTT në nen-grupet e SETSO TF (CBT /ITC, NACMPF- Network Access Congestion Management Power Flow, BM – Balancing Mechanism). EMS është duke penguar në vazhdimësi pjesëmarrjen e KOSTT në këto nëngrupe
- Nënshkrimi i marrëveshjes ITC/CBT të nivelit Evropian (ETSO dhe SETCO)
- Arritja e marrëveshjes lidhur me Borxhin që EMS i detyrohet KOSTT për tranzitin e energjisë për periudhën korrik 2004 deri në qershor 2007

**Progresi në kuadër të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE-së)
Për periudhën shkurt-prill 2007**

Puna në vazhdim në kuadër të TKE-së:

1. Draft Ligji për Gaz që se shpejti do të paraqitet për diskutim në grupin punues të nivelit qeveritar
2. Draft Deklarata për Sigurinë e Furnizimit me Energji për periudhën afatmesme që ka përfunduar dhe se shpejti do të dërgohet në Sekretariatit e Traktatit për Energji në Vjene
3. Është përgatitur draft vendimi për themelimin e Komisionit Emergjent Teknik të Energjisë (siç kërkohet nga vendimi përkatës i qeverisë) dhe do të organizohet takimi i tij i parë brenda periudhës maj-qershor 2007
4. Do të kërkohet përgatita e planeve nga KOSTT sh.a. dhe KEK sh.a. (sa më shpejtë që të jetë e mundur) për situatat e emergjente të furnizimit me energji
5. Vazhdon promovimi i Programit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë 2007-2009
6. Do përfundojë përgatitja e Bilancit Energjetik për Vitin 2006, kjo deri në maj 2007
7. MEM është duke koordinuar punën për të realizuar mobilizimin e financimit për ndërtimin e linjës së interkoneksionit 400KV ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Kjo detyrë po realizohet edhe në kuadër të një memorandumi mirëkuptimi midis Shqipërisë dhe Kosovës për këtë linjë.

Prioriteti 99: Përparimi i formulimit të strategjisë zhvillimore dhe planit afatmesëm është i lidhur me strategjitë sektoriale, merr parasysh zbutjen e varfërisë dhe është në pajtim me kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe programin publik të investimeve

Sa i përket Prioritetit 99 që ka të bëjë me Strategjitë zhvillimore, ne jemi duke punuar në mënyrë intensive që shumë shpejt ta kemi edhe Strategjinë e Xehetarisë. Deri më tani detyrat që janë kryer në kuadër të Strategjisë së Xehetarisë janë:

1. Grumbullimi i të dhënave
2. Vlerësimi i potencialit ekonomik
3. Zhvillimi i prioritetëve të veprimit
4. Ndërtimi i kapaciteteve

**Progresi në kuadër të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE-së)
Për periudhën shkurt-prill 2007**

Në bazë të kontratës me kompaninë konsulente që është duke punuar në këtë projekt, ky projekt do të duhet të përfundonte në tetor 2007. Mirëpo, në bazë të zhvillimeve dhe angazhimeve projekti do të realizohet më herët (Drafti i parë pritet të punohet në muajin maj të këtij viti).

Prioriteti 116: Hartimi i kornizave legislative dhe rregullative për të inkurajuar partneritetet publike-private dhe investimet e shumëllojshme në sektorin e energjisë

MEM po punon me MMPH dhe me ZRrE që të sqarohen procedurat për zbatimin e skemës më të përshtatshme për tërheqje të investimeve (kryesisht vendore) në ndërtimin e kapaciteteve të vogla hidroelektrike duke siguruar njëherësh shfrytëzim racional të burimeve ujore dhe të ardhura sa më të mëdha për BKK nga këto burime.

Në kuadër të projektit të madh 'Energjia nga Ligniti' jemi në fazën e Kujdesit të Duhur ku Investitorët e parakualifikuar potencial janë duke i kryer procedurat e kujdesit të duhur përmes vizitës së kapaciteteve gjeneruese ekzistuese në sektorin e energjisë, mbledhjen e të dhënave në Dhomën e të Dhënave në kuadër të MEM-it dhe po ashtu mbledhjen e informatave nga tereni.

II. Sfidat dhe problemet

Ndër sfidat që kemi përpara janë:

1. Vështirësitë potenciale që mund të dalin në procesin e hapjes së tregut të energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët jo-shtëpiak nga 1 Janari 2008.
2. Implikimet sociale të reformave dhe ristrukturimit – nevoja për mbështetje të dedikuar nga BE.
3. Mospranimi i Serbisë për t'i paguar Kosovës tranzitin e energjisë elektrike, përderisa KOSTT paguan rregullisht EPS.
4. Nevoja për fonde për të implementuar një numër të projekteve për eficiencën e energjisë dhe burime të ripërtërishme.